

Njoftim i Keshillit Kombetar te Kontabilitetit

Date 11.01.2012

<http://www.kkk.gov.al/artikull.php?id=243>

Kujtesë mbi zbatimin e Lgjit "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, meqenëse jemi në periudhën e përgatitjes së Pasqyrave Financiare për vitin ushtrimor 2011, shohim me vend që të bëjmë një kujtesë:

I. Përgatitja e Pasqyrave Financiare do të bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nga këto njësi ekonomike:

- a) nga shoqëritë e listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë dhe filialet e tyre, subjekt i konsolidimit të llogarive;
- b) nga bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare, të ngjashme me bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe të risigurimeve, fondet e letrave me vlerë dhe të gjitha shoqëritë e licencuara për të kryer veprimtari investimi në letrat me vlerë, edhe kur ato nuk janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë;
- c) nga njësi ekonomike të tjera të mëdha, të palistuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë, kur ato tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për të ardhurat vjetore dhe numrin e të punësuarve me VKM 742, datë 07.11.2007, pika 2, ku shprehimisht thuhet:

Njësitë e tjera ekonomike, të cilat nuk janë objekt i ligjit të sipërpërmendur, do të jenë subjekt i zbatimit të SNK, kur tejkalojnë njëkohësisht, për dy vitet e fundit, këto kufij:

- 1) Të ardhurat vjetore në shumën 1.250.000.000 lekë;
- 2) Numri mesatar i të punësuarve, mbi 100 punonjës në vit

II. Të gjitha njësitë e tjera ekonomike duhet të zbatojnë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ky grup njësisht ndahet në:

- a) njësitë ekonomike që do të zbatojnë standardet SKK 1 deri në SKK 14
- b) dhe grupin e Mikronjësive që hartojnë Pasqyra Financiare sipas SKK 15 të cialt janë njësitë ekonomike ku punësohen më pak se 10 persona dhe kanë një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë. Këto kritere duhet të plotësohen për dy vitet e fundit.

III. Përsa i përket mikronjësive me status person fizik dhe që realizojnë xhiro vjetore deri në 2 milion lek, ato do të mbajnë kontabilitetin e thjeshtuar me regjistrim të njëfishtë në bazë monetare. Këto njësi nuk kanë detyrimin të hartojnë pasqyra financiare.

Keshilli Kombetar i Kontabilitetit

Rr. 'Bulevardi Dëshmorët e 4 Shkurtit'

Nr 6, Tiranë.

Tel: 0355 (42) 220 499

Fax: 0355 (42) 220 466

www.kkk.gov.al

E-mail: info@kkk.gov.al